

Për: Deputetët e Kuvendit të Kosovës
Nga: BIRN dhe ARTICLE 19
Subjekti: Rekomandime për draftligjin për mbrojtjen e burimeve
Data: 15 maj 2013

Shënim: këto rekomandime u janë dërguar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës përmes adresës elektronike dhe në kopje fizike.

Hyrje

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe organizata ARTICLE 19 mirëpresin projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, i cili është kaluar për në lexim të parë nga Komisioni për Media i Kuvendit të Kosovës, më 29 prill 2013. Ne i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që të miratojë projektligjin me rekomandimet e mëposhtme.

Aktualisht Kosova nuk ka bazë ligjore për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Kushtetuta e Kosovës, kodi penal dhe kodi i procedurës, janë të heshtura në këtë drejtim dhe nuk e rregullojnë mbrojtjen e burimeve. Kushtetuta parasheh parime të përgjithshme për mbrojtjen e lirisë së mediave dhe së drejtës për t'u shprehur, por parimet nuk mund të mbrojnë konkretisht burimet, gjë që mund të çojë në konflikt ligjor dhe kështu të shkaktojë zvogëlimin e kësaj të drejte themelore. Kjo është arsyeja pse shtete europiane të cilat e kanë të paraparë në Kushtetutë lirinë e mediave, prapëseprapë kanë ligj për mbrojtjen e burimeve.

Në të njëjtën kohë, kodi i procedurës penale ka një nen që ia ndalon gjykatës të ftojë një gazetar në cilësinë e dëshmitarit. Por, duhet të qartësohet fakti që gazetari mbrohet me kodin e procedurës penale, vetëm në cilësinë e dëshmitarit. Për shembull, nëse një gazetar rastis të jetë prezent ose shih kryerjen e një veprë penale, atëherë ai nuk ftohet si dëshmitar. Mirëpo, ky nen nuk e mbron gazetarin, nëse ai ftohet të tregojë burimin e tij.

Këshilli i Europës përmes Rekomandimit nr. (2000) 7 të Komitetit të Ministrave dhe së fundi Rekomandimit të Asamblesë Parlamentare 195 (2011) fton të gjitha shtetet anëtare të “miratojnë legjislacion për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve”.¹

¹ Rekomandimi 1950 (2011) i Këshillit të Europës për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, mund të gjendet në: <http://assembly.coe.int/mainf.asp?Link=/documents/adoptedtext/tal1/erec1950.htm>

Shumica e shteteve të zhvilluara mbrojnë burimet me ligj të veçantë, me nen specifik kushtetues, me kod penal ose me akte të tjera juridike. Shtetet të cilat deri më tani kanë miratuar këtë ligj janë Austria, Norvegjia, Belgjika, Franca, Anglia, Zvicra dhe Gjermania. Në shtete si, Spanja, Portugalia, Andorra dhe Gjermania mbrohet me kushtetutë. (Në Gjermani ekziston një vendim gjyqësor sipas së cilit mbrojtja e burimit konsiderohet e mbrojtur me Kushtetutë).²

Legjislacion të mirë për mbrojtjen e burimeve kanë edhe Armenia, Kroacia, Qiproja, Danimarka, Finlanda, Gjeorgjia, Litenshtajni, Lituania, Malta, Norvegjia, Polonia, Romania, Suedia dhe Turqia.³

Pavarësisht se a kanë miratuar shtetet europiane legjislacion konkret për mbrojtjen e burimeve, në Europë zbatohen vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Për shembull në rastin *Goodwin v. Mbretëria e Bashkuar* gjykata angleze kishte urdhëruar një gazetar që të zbulonte identitetin e burimit, i cili kishte ofruar informata konfidenciale të një kompanie por Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka kundërshtuar këtë dhe vendosur që shtetet duhet të njohin të drejtën e mbrojtjes së burimeve. Në dy raste të tjera, Gjykata europiane për të Drejtat e Njeriut gjithashtu ka vendosur që të kufizohet bastisja (kontrollimi) e zyrave dhe shtëpive të gazetarëve (rasti *Tillack v. Belgjika* 2007) dhe përgjimi i tyre (rasti *De Telegraaf v. Holanda*, 2012).

Draftligji i proceduar në lexim të parë ka mangësi, sepse duket që nuk ka marrë parasysh praktikat më të reja të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, rolin e teknologjisë informative në media dhe rekomandimet e Këshillit të Europës.

Projektligji për mbrojtjen e burimeve është i bazuar në ligjin e Belgjikës, i cili edhe pse ende konsiderohet si ligji më i mirë në Europë, përsëri ka nevojë të azhurnohet me zhvillime të reja që kanë ndodhur në fushën e gazetarisë.

Prandaj, në mënyrë që ky draftligj të jetë i kompletuar dhe në përputhje të plotë me standardet europiane BIRN'i dhe ARTICLE 19, organizata këto të specializuara në fushën e së drejtës së mediave, propozojnë rekomandimet e mëposhtme:

Rekomandimet

Neni 2 – fushëveprimi

Sipas këtij neni, ligji vlen vetëm për “qytetarët e Republikës së Kosovës dhe persona të tjerë jorezidentë” por rreziku është që ky ligj mund të mos aplikohet për të huajt të cilët janë banorë/rezidentë në Kosovë. Në vijim të këtij neni në

² Shih raportin “Legal Protections and Barriers on the Right to Information, State Secrets and Protection of Sources in OSCE Participating States”, 2007, publikuar nga OSCE, faqe 25

³ Këto të dhëna mund të gjinden në raportin me titull “Access to information by the media in the OSCE region: trends and recommendations” të botuar nga OSBE-ja, më 2007, faqe 11

mënyrë të paqartë thuhet se “nuk mund t’u mohohet mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve të garantuara nga ky ligj” fjali kjo që në mënyrë të paqartë kualifikon mbrojtjen e të drejtave dhe rrezikon që të bëjë të kundërtën e saj.

Rekomandimi: Ky nen të ndryshohet si në vijim “ky ligj është i zbatueshëm për të gjithë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias të cilët veprojnë nën juridikisionin e Republikës së Kosovës”.

Neni 3.1.2 – Përkufizimet

Përkufizimi për “gazetar” është i ngushtë, sepse duket që vlen vetëm për ata persona të cilët shpërndajnë informacione përmes mediave profesionale. Meqenëse termi “media” nuk është i përcaktuar me këtë ligj, atëherë kjo lë të nënkuptohet që gazetarë janë vetëm ata persona që punojnë në medime profesionale. Në këtë rast përjashtohen blogerët, personat që shkruajnë libra, ose organizatat joqeveritare, të cilat merren me hulumtime dhe publikojnë raporte.

Rekomandimi: Neni 3.1.2 të ndryshohet si në vijim: “Gazetarë janë personat fizikë ose juridikë të cilët rregullisht ose profesionalisht janë të përfshirë në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve në publik, përmes çfarëdo mënyre të komunikimit masiv, përfshirë komunikimin përmes teknologjisë informative.”⁴

Neni 3.1.3 – Përkufizimet

Përkufizimi për “profesionistët e mediave” është gjithashtu shumë i ngushtë, pasi që nuk përfshin personat fizikë ose juridikë që mund të jenë të kontraktuar nga jashtë për t’u ofruar shërbime profesionistëve të mediave, si për shembull: shtëpive botuese, kompanive të sajteve etj.

Rekomandimi: Neni 3.1.3 të ndryshohet si në vijim: “ky term nënkupton stafin editorial dhe çdokënd jashtë stafit redaktorial, i cili gjatë ushtrimit të funksionit ose përmes marrëdhënieve profesionale me media, mund të jetë në pozitë që të ketë njohuri për informacionin që mund të çojë tek zbulimi i burimit, pavarësisht nëse ky bëhet përmes mbledhjes, trajtimit editorial, produksionit apo shpërndarjes së informacionit. Termi përfshin gjithashtu kameramanët, fotografët, stafin e tyre mbështetës siç janë shoferët, përkthyesit dhe të tjerët dhe çdo person fizik apo juridik që ka marrëdhënie profesionale me media”.⁵

Neni 3.1.5

⁴ Ky definicion është marrë nga Rekomandimi i Këshillit të Europës R (2000) 7 për të drejtën e gazetarëve që të mos tregojnë burimet e tyre, mund të gjendet në:

[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec\(2000\)007&expmem_EN.asp](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec(2000)007&expmem_EN.asp)

⁵ Edhe ky definicion gjendet në Rekomandimin e Këshillit të Europës R (2000) 7 për të drejtën e gazetarëve që të mos tregojnë burimet e tyre.

Përkufizimi për “materiale” nuk është i plotë, sepse nuk përfshin të dhënat që mund të jenë në kompjuterë, hard disk dhe informatat të tjera të medimeve, usb ose mënyra të tjera.

Rekomandimi: Neni 3.1.5 – definicionit për “materiale” duhet t’i shtohet fjalia “informacione të mbledhura në çfarëdo mënyre, përfshirë, por duke mos u kufizuar, edhe në të dhëna në kompjuterë, hard disk dhe informatat tjera të mediumit”

Neni 4

Ky nen duhet të përmbajë edhe një paragraf me të cilin sigurohen gazetarët që të mos zbulojnë dokumente ose informacione të cilat mund të tregojnë storjen të cilën është duke e hulumtuar gazetari. Pra përveç që duhet të mbrohet burimi, gazetarët duhet të mbrojnë edhe çdo informacion që mund të çojë në zbulimin e storjeve të cilët janë duke hulumtuar.

Rekomandimi: nën pikën 4.4 të shtohet pika 5 me tekstin si në vijim “mund të zbulojë përmbajtjen e informacioneve ose dokumenteve të cilat mund të çojnë në zbulimin e storjes të cilën është duke e hulumtuar gazetari”.

Neni 5.1

Zbulimi i burimit ose informacioneve nuk duhet të bëhet me kërkesë të gjykatësit, por me vendim të shkruar të gjykatësit.

Rekomandim: neni 5.1 të ndryshohet si në vijim “Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të detyruar të zbulojnë identitetin e burimit të informacionit siç referohet në nenin 4, vetëm me vendim të shkruar gjyqësor dhe vetëm nëse...”

Neni 6

Ky nen nuk ofron mbrojtje dhe siguri të plotë për gazetarë dhe profesionistë të mediave. Neni duhet të zgjerohet, ashtu që të përcaktojë ndalesa në përdorimin e teknikave të ndryshme hetuese, që mund të përdoren ndaj gazetarëve si përgjimet telefonike, përgjimet dhe ndjekjet e gazetarëve etj.

Rekomandim: në përputhje me rekomandimin e Këshillit të Europës neni 6.1 duhet të ndryshohet si në vijim: “Çdo masë e zbulimit apo investigimit që synon të identifikojë burimin e informacionit si më poshtë, është e ndaluar: kontrolli në shtëpi, ndërtesa të kompanive mediatike, ose çdo kompani të komunikimit online me publikun, të agjencive të lajmeve, në automjetet e këtyre kompanive apo agjencive, ose shtëpitë e gazetarëve. Ndalohet edhe përgjimi i komunikimit ose të dhënave komunikuese dhe çfarëdo lloji i korrespondencës së gazetarëve ose të punëdhënësve të tyre dhe përgjimi ose ndjekja e gazetarëve, kontakteve të tyre ose punëdhënësve të tyre.”

Rreth BIRN-it

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuose është organizatë joqeveritare e cila prodhon emisionet Jeta në Kosovë, Drejtësia në Kosovë, Gazetën Jeta në Kosovë dhe të vetmen gazetë në gjuhën angleze Prishtina Insight. BIRN'i gjithashtu merret me zhvillimin e mediave, ngritjen e kapaciteteve të gazetarisë, zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe përmirësimin e legjislacionit, duke u fokusuar në të drejtën e medias. Organizata përbëhet nga një grup i ngushtë i redaktorëve dhe trajnuesve që merren me gazetari analitike dhe huluntuose mbi tema komplekse politike, ekonomike dhe sociale.

www.birn.eu.com

Rreth Article 19

Article 19 është organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e cila mbron dhe promovon lirinë e shprehjes në tërë botën. Article 19 beson që liria e shprehjes dhe qasja në informacione nuk është luks por është e drejtë thelbësore e njeriut. Organizata gjithashtu bën kampanjë kundër përdorimit të tepërt të ligjeve për shpifje, kufizimeve të mediave dhe cenurës. Article 19 ka intervenuar në rastet gjyqësore Goodwin v. Mbretëria e Bashkuar dhe Sanoma v. Holanda dhe rrjedhimisht është aktive në promovimin e të drejtës së gazetarëve në mbrojtjen e të drejtave të tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në tërë botën. Organizata është e regjistruar në Angli dhe në tetë shtete tjera. www.article19.org